

<b>SYLLABUS</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Juridik - Universiteti i Prishtinës</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b><i>E DREJTA PENALE KRAHASUESE</i></b>
<b>Niveli:</b>	Studimet Master – Drejtimi Penal
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti I, semestri II
<b>Numri i orëve në javë:</b>	3
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	5
<b>Profesori i lëndës:</b>	<b><i>Prof.Ass.Dr. Avni Puka, PhD</i></b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<i>avni.puka@uni-pr.edu</i>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Në kuadër të kësaj lënde përfshihet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Objekti i studimit të së drejtës penale krahasuese (<i>Studimi i dallimeve dhe ngjashmërive midis dy ose më shumë të drejtave penale të vendeve/sistemeve të ndryshme</i>);</li> <li>- Karakteristikat themelore, burimet dhe metodat e studimit të së drejtës penale krahasuese;</li> <li>- Studimi i së drejtës penale në disa vende (<i>përfshirë sistemet kryesore juridike</i>) dhe krahasimi me të drejtën penale pozitive në Kosovë;</li> <li>- Studimi nga aspekti krahasues i disa prej parimeve dhe instituteve themelore të së drejtës penale, duke analizuar doktrinën dhe legjislacionin e vendeve të ndryshme, si edhe standardet e përcaktuara në nivel evropian dhe botëror.</li> </ul>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimi i studimit të kësaj lënde është që studentët e nivelit Master të përfitojnë njohuri të avancuara mbi parimet dhe institutet themelore të së drejtës penale, duke i studiuar nga aspekti krahasues.</p> <p>Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që studentët të njohin të drejtat penale të disa prej vendeve që përfaqësojnë modele dhe sisteme të ndryshme, të njohin metodat e së drejtës penale krahasuese, si dhe të zhvillojnë shkathtësitë e tyre për analiza krahasuese mbi çështjet e së drejtës penale në përgjithësi.</p>
<b>Rezultatet e pritura:</b>	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde/programi, pritët që studentët të kenë aftësinë për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të studiuar në mënyrë të pavarur dhe me kompetencë çështjet penale nga perspektiva krahasuese;</li> <li>- të formuar një koncept të qartë mbi të drejtën penale krahasuese dhe rolin e saj në avancimin e të drejtës</li> </ul>

	<p>penale të shteteve dhe të drejtës penale ndërkombëtare;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të konceptuar me saktësi se studimi krahasues i instituteve dhe parimeve të së drejtës penale është me interes të posaçëm për formimin e tyre profesional;</li> <li>- të konceptuar se në botën moderne është i vështirë miratimi i ligjeve sistemore (kodeve) dhe ligjeve tjera në çdo fushë, duke përfshirë atë penale, pa mbështetjen në modelet krahasuese.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	/	/	/
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume,seminare	1	1	1
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	/	/	/
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	3	3
Projektet,prezentimet e studentëve ,etj	1	15	15
<b>Totali</b>			<b>154</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Gjatë ligjëratave dhe punës hulumtuese të studentëve do të aplikohen këto metoda kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Metoda e mësimdhënies aktive.</i></li> <li>- <i>~ e mësimdhënies inter-aktive.</i></li> <li>- <i>~ krahasuese.</i></li> <li>- <i>~ e analizës.</i></li> <li>- <i>~ e studimit të rasteve.</i></li> <li>- <i>~ historike.</i></li> </ul>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Vlerësimi bazohet në aktivitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Pjesëmarrja aktive (nëpërmjet diskutimeve) në ligjërata dhe në ushtrime (deri 15 %)</i></li> <li>- <i>Prezantimi në ligjërata - detyra për studentin (deri 15%)</i></li> <li>- <i>Dorëzimi i punimit/esesë me shkrim (4-7 faqe) e dorëzuar në të njëjtën temë (deri 30 %);</i></li> <li>- <i>Provimi final (40%)</i></li> </ul>		

<b>• Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shegani, A.: E drejta penale e krahasuar, Tiranë 2008.</li> <li>- Salihu, I: E Drejta Penale (Pjesa e Përgjithshme), Prishtinë, 2015</li> <li>- Salihu, I: E drejta penale - pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014.</li> <li>- Puka, A: E Drejta Penale, HYRJE NË SISTEMIN LIGJOR TË KOSOVËS, Prishtinë, 2019, fq.270-308 (<a href="http://jus.igjk.rks-gov.net/787/">http://jus.igjk.rks-gov.net/787/</a>).</li> <li>- Puka, A: E Drejta Penale, FJALOR JURIDIK (E drejta private - E drejta publike – e drejta penale), Prishtinë, 2019, fq.235- 320 (<a href="http://jus.igjk.rks-gov.net/786/">http://jus.igjk.rks-gov.net/786/</a>)</li> <li>- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, (2019).</li> <li>- Materiale të propozuara nga mësimdhënësi.</li> </ul>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Cadoppi, A., Pradel, J.: Casi di diritto penale comparato, <i>Giuffrè</i>, 2005.</li> <li>- Cadoppi, A.: Introduzione allo studio del diritto penale comparato, <i>CEDAM</i>, 2004.</li> <li>- Cadoppi, Alberto: Tra storia e comparazione. Studi di diritto penale comparato, <i>CEDAM</i>, 2014.</li> <li>- Dammer, H.R., Albanese, J.S.: Comparative Criminal Justice Systems, <i>Wadsworth</i>, 2014.</li> <li>- Eser, A.: Comparative Criminal Law, <i>C.H.Beck- Hart-Nomos</i>, 2017.</li> <li>- Fields, Ch.B., Moore, R.H.Jr: Comparative Criminal Justice, <i>Waveland Press</i>, 1996.</li> <li>- Gallant, K.S.: The Principle of Legality in International and Comparative Criminal Law, <i>Cambridge University Press</i>, 2008</li> <li>- Geary, R.: Understanding Criminal Law, London , 2002.</li> <li>- Hall, J.: General Principles of Criminal Law, New Jersey, 2005.</li> <li>- Heller, K. J &amp; Dubber M.D. The Handbook of Comparative Criminal Law, <i>Stanford University Press</i>, 2011.</li> <li>- Kejler, J.m Roef, D. (eds): Comparative Concepts of Criminal Law, 2019.</li> <li>- Nelken, D.: Comparative Criminal Justice, London, 2010.</li> <li>- Nijboer, J.F. Comparative Criminal Law and Procedure: An Introduction, <i>Kluwer</i>, 2005.</li> <li>- Oudah, A.Q.: Criminal Law of Islam, <i>Kitab Bhavan</i>, 1999.</li> <li>- Anwarullah, M.: Criminal Law of Islam, <i>Kitab Bhavan</i>, 2006.</li> <li>- Palazzo, F., Papa M.: Lezioni di diritto penale</li> </ul>

	<p>comparato, <i>Giappichelli</i>, 2013.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Peters, R.: <i>Crime and Punishment in Islamic Law</i>, Cambridge University Pres, 2005.</li> <li>- Philip E.Carlan, etc.: <i>An Introduction to Criminal Law</i>, London 2010.</li> <li>- Reichel, Ph.L.: <i>Comparative Criminal Justice Systems: A Topical Approach</i>, 2017</li> <li>- Terrill, R.J.: <i>World Criminal Justice Systems: A Comparative Survey</i> 9<sup>th</sup> Ed, New York, 2016.</li> </ul>
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>
<b><i>Java I</i></b>	<p>Trajtime të përgjithshme mbi të drejtën penale krahasuese; Përkufizimi i të drejtës penale krahasuese; Objekti i studimit të së drejtës penale krahasuese (<i>Studimi i dallimeve dhe ngjashmërive midis dy ose më shumë të drejtave penale/sistemeve juridiko-penale</i>) Diskutimi në lidhje me metodat e mësimdhënies, literaturën dhe detyrat për studentët.</p>
<b><i>Java II</i></b>	<p>E drejta penale krahasuese si disiplinë shkencore Historia e të drejtës krahasuese - me theks të veçantë i të drejtës penale krahasuese Karakteristikat themelore të së drejtës penale krahasuese Metodat e studimit të së drejtës penale krahasuese</p>
<b><i>Java III</i></b>	<p>Faktorët që favorizojnë studimin e së drejtës penale krahasuese Aktualiteti dhe rëndësia e studimeve krahasuese në fushën penale <u><i>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</i></u></p>
<b><i>Java IV</i></b>	<p>Raporti i së drejtës penale krahasuese me disiplinat e tjera si: E drejta penale ndërkombëtare, E drejta penale evropiane, politika kriminale, etj.(debat me studentë). <u><i>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</i></u></p>
<b><i>Java V</i></b>	<p>Burimet e së drejtës penale krahasuese (konventat, kushtetutat, ligjet/kodet penale, e drejta zakonore, praktika gjyqësore). Parimet e përgjithshme të së drejtës penale – aspekte krahasuese <u><i>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</i></u></p>
<b><i>Java VI</i></b>	<p>Prezantimi i zgjidhjeve/modeleve të përfshira në dokumentet ndërkombëtare (konventat, rezolutat, statutet dhe aktet e tjera) dhe në kodet apo ligjet penale të vendeve të ndryshme Modelet e pranimit të instituteve të reja në fushën penale: <i>Instituti i përgjegjësisë së personave juridikë për vepra penale –</i></p>

	<i>aspekte krahasuese të modeleve ligjore në disa vende</i> <u><i>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</i></u>
<b>Java VII</b>	Krahasimi i instituteve themelore të së drejtës penale si: vepra penale, përgjegjësia penale (fajësia), bazat e përjashtimit të kundërligjshmërisë, etj. <u><i>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</i></u>
<b>Java VIII</b>	Sistemi i sanksioneve penale – aspekte krahasuese <u><i>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</i></u>
<b>Java IX</b>	Disa nga të drejtat themelore në procedurë penale – aspekte krahasuese me standardet ndërkombëtare dhe detyrimet e shteteve <u><i>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</i></u>
<b>Java X</b>	E Drejta penale në sistemin <i>Civil Law</i> (Karakteristikat e përgjithshme) <i>Kodifikimi i së drejtës penale</i> E Drejta penale në sistemin <i>Common Law</i> (Karakteristikat e përgjithshme) <u><i>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</i></u>
<b>Java XI</b>	E Drejta penale në disa vende të sistemit <i>Civil Law</i> : Itali Gjermani, Francë <u><i>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</i></u>
<b>Java XII</b>	E Drejta penale në disa vende të sistemit <i>Civil Law</i> : Holandë Belgjikë Spanjë <u><i>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</i></u>
<b>Java XIII</b>	E Drejta penale në disa vende të sistemit <i>Common Law</i> : Britania e Madhe - Parimet, burimet, institutet kryesore, sanksionet penale. (Diskutim me studentët). Sistemi i amerikan i drejtësisë penale Sistemi i drejtësisë penale në Australi <u><i>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</i></u>

	<i>drejtës penale – detyrë për studentët</i>
<b>Java XIV</b>	<p>E drejta penale në vendet e Amerikës Latine (Argjentinë, Brazil, etj)</p> <p>Sistemi i drejtësisë penale në Vendet e Lindjes</p> <p>E drejta penale në Islam – veçoritë kryesore</p> <p>E drejta penale në sistemin japonez</p> <p><u>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</u></p>
<b>Java XV</b>	<p><u>Prezantim nga aspekti krahasues i një instituti apo parimi të së drejtës penale – detyrë për studentët</u></p> <p>Përmbledhje e temave të trajtuara (debat me studentë)</p> <p>Diskutim në lidhje me vlerësimin final</p>
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nga studentët kërkohet që të jenë të rregullt në ligjërata dhe inkurajohen të jenë aktiv me pyetje dhe diskutime rreth tematikave të lëndës;</li> <li>- Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e detyrueshme dhe shumë e rëndësishme për të realizuar qëllimin e lëndës/programit;</li> <li>- Studentët do të udhëzohen në vazhdimësi për zhvillim të shkathtësive hulumtuese të pavarura;</li> <li>- Ligjëratat dhe vlerësimi do të jetë në pajtim me programin dhe informimin paraprak të studentëve.</li> <li>- Sjellja në pajtim me rregulloren dhe standardet etike të përcaktuara nga universiteti. Studentët dhe mësuesit duhet të ruajnë standardet më të larta të ndershmërisë dhe integritetit akademik.</li> </ul>	